

Paraqitje e Shkurtë

Diskurs domethanë të flasësh me dikë, çka nënkupton nevojën me u kuptua, e cila qet në pah kompetencën gjuhsore. Kështu, në varsi prej kompetencës gjuhsore të diskursistëve, diskursi mund të zhvillohet në nivele të ndryshëme, p.sh., analfabetik, slangesk, zhargonesk, popullor ose teknik, letrar, akademik, e të tjera.

analfabetik – Diskursistëve u mungon aftësia me shkrua e lexua. Por, kjo nuk do të thotë që diskurse të tilla nuk janë inteligjente. Përgjatë historisë, shumica e njerëzve më të urtë nuk dinin as shkrim as lexim.

slangesk – Diskursistët kuptohen vetëm brenda një grupi shoqnor. Fjalët mund të përdoren edhe prej të tjerëve, por me kuptime të ndryshëme, p.sh., legen - *një i burgosun që u shërben të tjerëve*; legen – *një enë me lá duart*. Në varsi prej rrethanave, *Ma sill legenin këtu!* ka kuptime të ndryshëme.

zhargonesk – Diskursi kuptohet vetëm prej antarëve të një profesioni. Pjesa tjetër e popullsisë mund të përdori një fjalë tjetër. Në zhargonin e policisë, *'informant'* do të thotë një person që njofton policinë rreth aktiviteteve kriminale. Në varsi prej ambientit shoqnor ose krahinës, njerëzit mund të përdorin një fjalë tjetër me etiketua këtë person, p.sh., *'spion, kalec, fuk'*. Dý fjalët e fundit u përkasin slangjeve, por ato mund të jenë edhe pjesë e zhargonit të të burgosunve, p.sh., *Ule zanin se po kalon Hysë Fuksi*.

popullor – Diskursi zhvillohet në gjuhë popullore, p.sh., **fansat** e futbollit zhvillojnë debate rreth ekipeve të tyre të përferuome.

teknik – Një debat rreth Windows (sistem operimi për kompjutra)

letrar – Që lidhet me veprat e shkruome; mund të kontrastohet me diskursin analfabetik.

akademik – Diskurs ku dominojnë faktet, arsyeja, dhe toni objektiv.

Analiza e diskursit mund të shtrojë pyetje si:

- Përsë është organizuom diskursi në mënyrë sistematike? Përsë jo në mënyrë intuitive ose spontane?
- Si krijohen premisat dhe në çfarë mase ato mbështesin përfundimet?
- Çka lejohet dhe çka ndalohet me u thanë në diskurs?
- Kush e krijoi hapsinën ku do të zhvillohet diskursi?
- Si u krijua hapsina ku po zhvillohet diskursi?
- Kush e financon diskursin?

1. Duke qenë në një nivel më të naltë se debati për hir të debatit dhe biseda e thjeshtë, diskursi është ndërkumtim i bazuom në argumente racionale që cakojnë me arritë marrveshje ndërmjet palësh që nuk pajtohen me njëna-tjetrën, ose palësh që përpiqen me riparua thymjen e ndërkumtimit; domethanë, diskursi nuk është bisedë e kotë. Ai ka cak të qartë.

Në qoftë se diskursi ka cak me riparua një thymje ndërkumti, natyra e tij varet prej natyrës së thymjes, e cila mund të jetë e përkohëshme ose e lehtë, por edhe e pamundun të riparohet; sëpaku mund të duket e tillë.

2. Prejse në diskurs përballen palë kundërshtare, diskursi anon më shumë kah *dialektika* sesa kah *logjika*, e cila nuk ka nevojë për partner as kundërshtues. Përveç arsyes a logjikës, qenja njerzore preokupohet edhe rreth nevojave e dëshirave. Prandaj, diskursi ka edhe natyrë *retorike*. Kështu, diskursi nuk mund të jetë puro logjik. Ai duhet kërkua diku në mes të bisedimit të thjeshtë dhe logjikës së ftohtë.

3. Detyra e secilit diskursist është t'i bindi të gjithë pjesmarrësit që zgjidhja e tij, a) është zgjidhja më e pranueshme, b) më e arsyeshme, dhe c) ajo nuk ka qëllime të liga ndaj ndonjë dasine të bashkësisë.

4. Në një diskurs të hapun, ka vend për mospajtime e kundërshtí. Diskursistët mund të *pajtohen*, por edhe mund të *pajtohen mos me u pajtua*. Për shembull, një diskursist mund të argumentojë që *liria e fjalës duhet të jetë aspekt themelor dhe i paprekëshëm i çdo bashkësie*. Një diskursist tjetër mund të argumentojë që *liria e fjalës çon në lëvizje populiste si komunizmi dhe bashkësitë përfundojnë nën regjime diktatoriale*.

Diskursisti mund të mbrojë çfardo bindieje, por ai duhet t'i mbështesi bindjet e tij me fakte të verifikueshme dhe arsyetim të shëndoshë, sepse caku i mëtejme i diskursistit është jo vetëm me fitua një diskurs, por me aplikua sunde e presa etike që mund të udhzojnë sjellejn e palëve kundërshtare edhe në kushte e rrethana të tjera. Në këtë aspekt, diskursi i ngjet caktut të Plakut të Ligjit në traditën shqiptare. Kur Ligji i Lekëve zbatohet, plakuri që merret me pleqnia një mospajtim, përpiqet me gjetë një herje të ngjashme ku një plak para tij i kishte dhanë zgjidhje këtij problemi.

4. Diskursistët duhet ta kuptojnë njëni-tjetrin. Prandaj, pyetet, *Çka do të thotë 'me kuptua'?*

Me 'të kuptuom' nuk kihet parasysh ideja kantiane, ku diskursisti është i painteresuem në subjektin e diskursit; ku ai kërkon të kuptojë diçka përtej enocioneve, ndjenjave, e interesave personale; në mënyrë puro intelektuale. Diskursistët, sado të mir-informuom që të jenë, ata janë qenje njerzore me dëshira, emocione, ndjenja, a caqe specifike. Prandaj, pikspari, koncepti 'diskurs' mbështetet në konceptin 'njeri'. Kështu, pyetja e masipërme duhet modifikua në, *Çka do të thotë me kuptua një njeri?* Në përgjigje duhen marrë parasysh *dija, vetdija, pavetdija, nevojat, dëshirat, droja, frika*, e të tjera, sepse të gjitha e

nxisin njeriun me diskursua dhe i përcaktojnë atij ose asaj cakun. Domethanë, të gjitha e nxisin diskursistin me fitua diskursin.

5. Diskursi duhet të dominohet prej meritës. Fjala ‘meritokraci’, e cila nuk duhet kuptua si një dhogaritje puro intelektuale, ashtu si fjala ‘demokraci’ përmban termin ‘kratos’, që do të thotë ‘fuqizim’ (megjithëse disa mund ta përkthejnë atë edhe si ‘fuqi’). Meritokracia duhet kuptua si fuqizim i meritës; jo i zanit më të nëltë, folësit më të shpejtë, njeriut më mashtrues, më fyes, e të tjera. Por, *merita nuk dubet ngatërrua me ekspertizën*. Njeriu mund të jetë ekspert b.f., në riparimin e kompjuterave, por ai nuk ka aftsitë e kerkuome me sundua një kompani që ofron këto shërbime.

Komunistët e dinin këtë, prandaj ata ua ndaluan si shkollimin si përfojën sunduese në shoqinë e tyre. Kur komunizmi rá, anti-komunistët e gjetën vetën pa shkollë e pa eksperiencë. Prandaj, ata ftuan ish-komunistët në detyrë, të cilët risollën disa metoda thalbsore të komunizmit; në mes tyre oligarkizmi, krahinizmi, dhe krimi i organizuom. Kështu, ata vazhdojnë të sundojnë prej në Kinë në Kroaci.

6. Diskursistët duhet të pajtohen që një zgjidhje ka merita të mjaftueshme; ose ka më shumë merita se zgjedhjet tjera. Por, siç u cek më nëlt, me ‘pajtim’ nënkuptohet që, 1) diskursistët pajtohen që të bashkpunojnë me njëni-tjetrin, ose 2) secila palë diskursive të punojë drejt një qëllimi të veçantë:

Pajtohemi që-të pajtohemi ose pajtohemi që-të-mos pajtohemi.